



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 202, Datë 27.09.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “M. C ENERGJI GOJAN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1845/5 prot., datë 23.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845 prot., datë 30.08.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW. Gjithashtu në këtë shkresë ajo ka kërkuar nga ERE që të marrë në konsideratë pagesën e kryer nga shoqëria në datën 10.10.2023, për të mos rënduar financiarisht shoqërinë. Kjo pagesë përkon me aplikim e shoqërisë për të cilin bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 374, datë 26.12.2023.
- Rezulton se shoqëria e ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në

sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” dhe “b”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmën “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën e Koncesionit e formës BOT me nr. 2515 Rep., nr. 1181 Kol., datë 06.11.2017 “Kontratë koncesioni e formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) për objektin “Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan”, të ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr. 2 Rep., Nr.2/3 Kol., datë 03.01.2019 dhe me Kontratën Shtesë Nr. 1990 Rep., Nr. 1465 Kol., datë 07.12.2022;
 - Është pajisur me Lejen e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor Nr. 1/2 prot., datë 20.04.2021, dhënë nga Këshillit i Basenit Ujor Mat, me afat vlefshmërie sipas kontratës koncesionare;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 17.10.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtim i HEC Gojan”, për fuqinë 15 MW.
- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.1. Formatit i aplikimit, sipas përcaktimeve të Shtojcës I bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të saktësojë deklarin e tij në lidhje me refuzimin më parë të një licence nga ERE.

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi mbështetjen financiare për realizimin e projektit, sipas vlerës që rezulton nga kontrata me MIE-n dhe sipas parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “c”**: (miratimin e operatorit të rrjetit (OST sha, ose OSSH sha) për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik) Aplikuesi duhet të depozitojë miratimin e OST sh.a. për lidhjen e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit.

- Gjithashtu, aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse kanë nisur punimet për ndërtimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion/dokumentacion në lidhje me zbatimin e afateve për ndërtimin dhe vënien në operim të centralit, referuar përcaktimeve të kontratës së nënshkruar me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh,” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “M. C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI